

### Si ta Luani Himnin “Një Kod'r e Blert' Ësht' Atje Larg”

Vendosini duart tuaja mbi tastierë siç tregohet më poshtë.

Përdorini grupet me dy dhe tre taste të zinj që t'ju ndihmojnë të gjeni pozicionin e saktë.

Luajeni këtë himn, duke ndjekur numrat e gishtave siç tregohet. Notat me bishtat lart janë për dorën e djathtë dhe notat me bishtat poshtë janë për të majtën. Ushtroni himnin derisa të mësoheni me të. Përdorini parimet e teknikës së mirë të vendosjes së gishtave të renditura në listën me nëntë pika.


Tani jeni njohur me lojën në piano dhe keni mësuar një melodi himni të thjeshtë. Për të luajtur himne të tjera, keni nevojë të mësoni disa parime bazë rreth goditjeve, ritmit dhe notave.

Ja ku është pjesa më e mirë: mësimi që sapo mësuar, është mësimi i parë në Kursin e Tastierës së Kishës, në dispozicion në gjashtë gjuhë nga shpërndarësi i Kishës.<sup>1</sup> Plani i udhëzimeve të lehta për t'u ndjekur ju ndihmon të mësoni vetë ose në grupe. Ju mund të përfshini edhe të gjithë familjen tuaj në mësimin e pianos së bashku si një

veprimtari për mbrëmjen familjare. Kursi mund të përfundojë në vetëm gjashtë javë.

Studime të shumta tregojnë që mësimet private të muzikës ndihmojnë të përmirësohet përqendrimi i studentit, shkëlqimi akademik dhe aftësitë e arsyetimit.<sup>2</sup>

Duke mësuar aftësi muzikore, ne i zhvillojmë talentet që Zoti na ka dhënë, shtojmë njohurinë tonë dhe mësojmë shumë mënyra të ndryshme në të cilat mund ta përdorim njohurinë tonë dhe talentet tona për të ndërtuar mbretërinë e Tij. ■



#### SHËNIME

1. Për të porositur Kompletin e Kursit të Tastierës, shkoni te [store.lids.org](http://store.lids.org).
2. Shih Laura Lewis Brown, “The Benefits of Music Education”, [pbs.org](http://pbs.org); Jessica Velasco, “How the Arts Can Help Students Excel”, the Science of Learning Blog, 11 dhjetor 2012, [scilearn.com/blog/how-arts-help-students-excel](http://scilearn.com/blog/how-arts-help-students-excel); “Music Helps Children Learn Maths”, *The Telegraph*, 22 mars 2012, [telegraph.co.uk](http://telegraph.co.uk).